



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

FIER

NJOFTIM

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË KONKURIMIT PËR EMERIMIN NË
POZICIONIN E PUNËS NJË VEND “PUNONJESE PASTRIMI”**

”Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier , kërkon të punësojë në pozicionin **1 (një)** punonjës në sektorin mbështetës me detyrë **”Punonjese pastrimi”**

Bazuar në Ligjin nr. 97/2016, datë 06.10.2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", Ligjin 7961/ date 12/07/1995 I perditsuar Kodi I punes

NJOFTON:

Fillimin e procedurës së hapur për konkurim të hapur të kandidatëve për pozicionin **I (një) vend “Punonjese pastrimi”** me kohe të plotë në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Të Juridiksionit të Përgjithshëm .

Kandidatët e interesuar për konkurim duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

1. Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojnë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje si dhe të mos jetë apo mos të ketë qënë nën hetim.
- Te mos jete ne ndjekje penale
- Te kete arsimin e mesem

2. Kushtet e posaçme:

- Të ketë aftësi për të krijuar marrëdhënie pune efektive me stafin e prokurorisë.
- Të ruajë sekretin hetimor.
- Të ketë integritet dhe cilësi të larta morale si dhe sjellje etike.

Personat e interesuar duhet të paraqesin zyrtarisht , Brenda dt 10/10/2023 ora 16⁰⁰ me poste ne adresen te Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë te Juridiksionit te Pergjithshem Fier ose drejtëpërdrejtë në sekretarinë e Prokurorisë Fier , te inventarizuara dokumentat e meposhtme :

- Kërkesë për punësim.
- Fotokopje e letërnjoftimit/kartës së identitetit/pasaportë.
- CV (Jetëshkrim) të detajuar së bashku me një foto.
- Deftese te shkollës së mesme ose vërtetim note fotokopje e noterizuar
- Dëshmi penaliteti.
- Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria që nuk ndiqet penalisht.
- Fotokopje te librezës së punës ose vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore që të provojë punësimin e mëparshëm dhe kohëzgjatja.
- Vërtetim vendbanimi.
- Vërtetim aftësie në punë nga institucionet shëndetsore.
- Adresen e e banimit, numer kontaktkti (numer telefoni ose adrese e –mail)

Pranimi i dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët do të bëhet në Kryesekretarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier , deri në datën 10/10/2023 ora 16.00 duke konfirmuar marrjen në dorëzim sipas inventarit të akteve të dorëzuara.

Verifikimi paraprak I përmbushjes së kushteve të përgjithshme dhe të vecanta për konkurim do të kryhet Brenda datë 11/10/2023 në ambientet e prokurorisë Fier dhe po Brenda dates 11/10/2023 do te shpallet lista e kandidatëve që plotësojnë kushtet e pergjithshme dhe te vecanta .

Shpallja behet ne stenden e Prokurorisë

Intervista me goje do te kryhet ne daten 12/10/2023 .

Kandidati gjate intervistes me goje do te vleresohet lidhur me:

- Aftesite komunikuese, njohurite per pozicionin e punes.
- Eksperienca e meparshme te punes (histori te shkurter mbi pune e meparshme)

Kriteret e vleresimit

- Vleresimi mbi dokumentacionit te pergjithshem dhe te vecante ,jeteshkrimi /experience 60 pike
 - Vleresimi I intervistes me goje 40 pike
- Ne perundim te vleresimit , Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë te Juridiksionit te Pergjithshem Fier do te njoftoje kandidatin fitues adresen e banimit/telefon ose adrese e-mail

Për çdo sqarim mund të kontaktoni në numrin 0342223, ose vizitoni faqen e internetit [ëëë.pp.gov.al](http://eëë.pp.gov.al).

**KOMISIONI I PRANIMIT PËR PROCEDURAT E PUNËSIMIT NË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
F I E R**

